



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 77-të, të mbajtur më 14.11.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-3204/1 të datës 27.08.2021, kundër personit juridik, -----, HIDHET POSHTË.

KSHPK konstatoi se sipas ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent për rastin në fjalë sepse në rastin kur bëhet fjalë për kërkesë për mbikëqyrje të punës së një person juridik privat.

Lënda me numër 3204/1 të datës 27.08. 2021 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur me datë 27.08.2021 është parashtruar denoncim kundër ----- dhe është formuar lëndë me numër 12-3204/1 të datës 27.08.2021.

Në denoncim, parashtruesi thekson se ----- nga Shkupi punon ilegalisht, me mos pagesë dhe fshehje të tatimit për në dëm të shtetit, dhe për llogari të tij realizon përfitime të mëdha financiare nga disa burime indirekte të lidhura, të cilat ai thekson se janë të paligjshme dhe të palejueshme.

parashtruesi në denoncim tregon edhe marrëdhënien e biznesit të subjektit të sipërpërmendur me drejtorin e ----- „-----" - -----, si dhe me fabrikën - ----- të ----- për transaksione të ndërsjella pa paguar tatimin përkatës, në dëm të Buxhetit të RMV-së. Është përmendur edhe punësimi i personave të afërt të drejtorit të -----.

Parashtruesi kërkon nga KSHPK-ja të mbikëqyrë punën e ----- në funksionimin financiar dhe të marrë masat e duhura në kompetencë të KSHPK-së.

Në denoncim theksohet gjithashtu se i njëjti denoncim do të dorëzohet edhe në Drejtorinë e Policisë Financiare.

Pas shqyrtimit të rastit në fjalë, KSHPK- ja ka konstatuar se në denoncim personi i përmendur nuk është zyrtar në kuptim të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të

Interesit, por është kërkesë për kontroll financiar të një personi juridik privat, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për trajtimin kompetent të lëndës në fjalë.

Duke pasur parasysh të theksuarën më sipër, KSHPK vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: Mr. K.Z.

Miratoi: Mr. SH.S, Anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Kryetare,
Biljana Ivanovska
